



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 312 Prot.

Tiranë, më 09.03.2023

V E N D I M

Nr. 36, Datë 09.03.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 32, datë 28.02.2023, e z. B.Z¹ kundër Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Zyrës Përmbarimore Lezhë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë”, “bindjes fetare” dhe “çdo shkak tjetër”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: “Jam në proces gjyqësor si paditës në çështjen civile-penale kundër shtetas F. Xh (ish bashkëshortja) e kallëzuar për veprat penale, fyerje dhe shpifje. Me kërkesë i jam drejtuar Zyrës Përmbarimore Lezhë për marrjen e video kasetave me pamjet filmike të regjistrimit të kamerave të monitorimit pranë Zyrës Përmbarimore Lezhë, kamerat tek korridori si dhe dy kamerat përballë dritareve të zyrës, si dhe kam kërkuar edhe proces verbalet e takimeve me fëmijën tim të mitur, A.Z, të realizuara pjesërisht në Zyrën e Përmbarimit Lezhë, takime me pengesa nga shtetasja F. Xh e favorizuar padrejtësisht nga përmbaruesja znj. S.Gj, me miratimin e kryetares znj. L.Ç, në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës Krujë, për inate personale ndaj meje, për arsye se i kam denoncuar për shpërdorim detyre, veprime arbitrare, shkelja e barazisë së shtetasve, nxitje të urrejtjes ndaj meje, për diskriminim fetar dhe racizëm.

Kam kërkuar marrjen e akteve pranë zyrës së përmbarimit, konkretisht për datat: 05.03.2021, 19.03.2021, 24.12.2021, 01.04.2022, 06.05.2022, 20.05.2022, 03.06.2023. Këto akte më janë kërkuar në seancë gjyqësore nga gjyqtari i çështjes z. I.P, para datës 20.03.2023 që është caktuar si seancë e administrimit të provave. Kryetarja e Zyrës së Përmbarimit Lezhë ka refuzuar të më japë marrjen e akteve, me justifikimin sipas saj se nuk është kompetencë e zyrës së përmbarimit.

¹ Ankuesi ka paraqitur pranë KMD-së dhe ankesën nr. 97, datë 13.06.2022, kundër Zyrës Përmbarimore Lezhë. KMD me Vendimin nr. 127, datë 23.06.2022 ka vendosur mospranimin e ankesës.

Me të njëjtën kërkesë i jam drejtuar edhe Gjykatës Lezhë për marrjen e akteve për audio kasetat, pamjet filmike të audio regjistrimit të kamerave. Gjykata e Lezhës nëpërmjet shkresës, kthim përgjigje, nuk pranon të më japë marrjen e këtyre akteve, çka unë e konsideroj si shkelje e të drejtave të njeriut dhe dallime me bazë krahinore, për arsye se jam nga rrethi i Krujës”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shprehimisht: *“Marrjen e masave urgjente dhe ushtrimin e kompetencave pranë organeve përkatëse kompetente, sipas ligjit”.*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Subjekti ankues, ka ngritur pretendime ndaj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Zyrës Përmbartimore Lezhë lidhur me mosvënien në dispozicion të regjistrimeve të pamjeve filmike të kamerave të monitorimit të Zyrës Përmbartimore Lezhë, të cilat duhet ti përdorë në çështjen gjyqësore që ankuesi është paditës kundër ish bashkëshortes së tij, çështje e cila po shqyrtohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Neni 135, pika 1 e Kushtetutës, bën dallimin midis gjyqtarëve sipas funksioneve dhe në të njëjtën kohë kërkon t'i shkëpusë ata nga varësia hierarkike dhe ia nënshtrojnë veprimtarinë e tyre në dhënien e drejtësisë, vetëm kontrollit të instancave më të larta gjyqësore, sipas rregullave të përcaktuara në kodet e procedurave.

Në nenin 145, të Kushtetutës, sanksionohet se, gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke nënkuptuar kështu, pavarësinë, përgjegjësinë dhe kompetencat e veçanta të gjyqtarit në dhënien e drejtësisë. Në nenin 147, pika 1 e Kushtetutës, përcaktohet se: *“Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*.

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, në nenin 158/a të tij ka përcaktuar vendimet e gjyqtarit gjatë veprimeve paraprake, në të cilat parashikohet se: *“Neni 2. Gjyqtari me vendim, pa caktuar seancë përgatitore, kryen këto veprime:*

- a) përjashton paditësin nga pagesa e tarifës kur janë rastet e përcaktuara me ligj dhe është bërë kërkesë nga paditësi;*
- b) cakton provat që do të merren në shqyrtim në seancë gjyqësore dhe cakton ekspertin në fushën përkatëse të ekspertizës, të cilin ua njofton palëve;*
- c) vendos për marrjen e provave dhe informacioneve tek të tretët kur palët deklarojnë dhe provojnë se nuk kanë mundësi t'i marrin vetë;*
- ç) vendos për marrjen e masave për sigurimin e padisë, në raste të veçanta ose të ngutshme, sipas nenit 205 të këtij Kodi;*
- d) nëse është e nevojshme, vendos për sigurimin e provës, sipas neneve 292-295, të këtij Kodi, dhe procedon për marrjen e saj në seancë të posaçme, sipas nenit 296 të këtij Kodi;”*.

Ligji nr. 7905, datë 21.03.1995 *“Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, në nenin 357 të tij ka përcaktuar disponimin e gjykatës lidhur me provat, në të cilat parashikohet se:

- 1. “Gjykata, pasi dëgjon palët, jep vendim për marrjen e provave.*
- 2. Gjatë shqyrtimit gjyqësor palët mund të bëjnë pretendime lidhur me marrjen e provave. Gjykata mund të revokojë me vendim marrjen e provave që dalin të panevojshme ose të pranojë marrjen e provave që kanë qenë refuzuar”.*

Në këtë kontekst, Komisioneri, vëren se gjykata është i vetmi organ që vendos lidhur me disponimin e provave, dhe pretendimi i subjektit ankues, për mosvënien në dispozicion të provave filmike lidhur me çështjen që është në shqyrtim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, mund të zgjidhet vetëm nëpërmjet kontrollit gjyqësor ose duke iu drejtuar Këshillit të Lartë të Gjyqësor² apo Inspektorit të Lartë të Drejtësisë³, të cilët janë organet kompetente të caktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për shqyrtimin e ankesave.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e çështjeve që janë kompetencë e organeve gjyqësore, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁴.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ky kërkim i ankuesit nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e tij.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 4/b, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës të paraqitur nga z. B.Z, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

² Neni 147/a, i Kushtetutës, përcakton ndër të tjera, se: *“Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve; b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve”*.

³ Neni 147/d, i Kushtetutës, përcakton ndër të tjera, se: *“Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë”*.

⁴ Për analogji citojmë Vendimet nr. 81, datë 26.04.2022, nr. 127, datë 23.06.2022 dhe nr. 132, datë 04.07.2022, të KMD-së.